



Nr. 181 Prot. Datë 08/07 2019.



Nr. 15 Prot. Datë 08/07 2019.

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ky memorandum lidhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

- **“Universiteti Europian i Tiranës” sh.p.k.**, me seli në: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Njësia Bashkiake Nr.7, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri, regjistruar me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) K62029010L, përfaqësuar rregullisht nga **z. Arbi Agalliu** në cilësinë e Administratorit, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, këtu e më poshtë referuar si **“UET”**.

DHE

- **Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)**, organizatë jo fitim-prurëse, regjistruar me Vendimin Nr. 1153, datë 14.04.1999 te Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, dhe me Nr. Nipti K51626015F, përfaqësuar nga **z. Spiro Brumbull**, Sekretar i Përgjithshëm, këtu e më poshtë referuar si **“AAB”**.

Neni 1

Objekti i Bashkëpunimit

Objekti i këtij memorandum është përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit midis UET dhe AAB. Institucionet e mësipërme bien dakord të bashkëpunojnë për një afat të pacaktuar kohor më njëra-tjetrën në fushat ku të dyja palët ushtrojnë aktivitetin e tyre kryesor dhe/ose plotësues.

Neni 2

Angazhimet e palëve

Palët angazhohen që pikat kryesore të bashkëpunimit të jenë:

I. Kualifikim / Specializime

UET do të ofrojë mundësinë për kualifikime afatgjata të ciklit Bachelor, Master Profesional, Master Shkencor, Master Ekzekutiv dhe Doktoraturë. Gjithashtu, do të ofrojë mundësinë e trajnimeve të certifikuara 3-12 javore në marketing, kërkim tregu, komunikim-biznes, menaxhim financiar, etj, në përputhje me kërkesat e AAB-s.

II. Konsulencë

UET do të ofrojë mundësinë për konsulencë të specializuar në një numër fushash, siç janë shërbimet e marrëdhënieve publike, marketingut, planet e kërkimit e tregut, shërbime juridike, shërbime të IT-së, etj.

III. Praktikë dhe Punësim

AAB në përputhje me domosdoshmëritë dhe mundësitë e disponueshme do të pranojë studentë në praktika profesionale /punësimi, internshipe, etj., apo do t'i rekomandojë të njëjtën gjë bankave anëtare duke iu dhënë mundësinë studentëve të UET të shfaqin /përmirësojnë aftësitë e tyre profesionale, si dhe mundësi punësimi.

IV. Edukim financiar

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushën e edukimit financiar, duke u dakordësuar rast pas rasti për projekte të cilat mund të paraqiten nga secila palë.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Palët marrin përsipër që, në përputhje me interesat institucionale, mundësitë e tyre dhe kapacitetet përkatëse, të vendosin në dispozicion të njëra-tjetrës burimet njerëzore dhe materiale, jo domosdoshmërisht burime financiare, për arritjen e qëllimeve që parashikon kjo marrëveshje.



2

Institucionet do të ruajnë konfidencialitetin e njëra-tjetrës, për të cilat do të vendosen në dijeni si rrjedhojë e bashkëpunimit të ndërsjellë të palëve. Palët do të nxisin njëra-tjetrën për një bashkëpunim sa më të gjerë dhe intensiv duke eksploruar fusha të tjera bashkëpunimi.

Neni 4

Interpretimet

Palët do të interpretojnë çdo pikë të kësaj marrëveshje, duke marrë parasysh vullnetin dhe dëshirën e mirë të secilës prej palëve, deri në nënshkrimin e kësaj marrëveshje.

Kjo marrëveshje nuk mund të jetë pjesë e ndonjë konflikti gjyqësor.

Neni 5

Komunikimi

Palët do të caktojnë personat e kontaktit që do të jenë përgjegjës për zbatimin e Memorandumit, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe efektiv. Në rastet e shmangies nga procedurat e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Personat e kontaktit për secilën palë, në kuadër të implementimit të këtij memorandumi janë:

Për AAB:

Z./ Znj. Junida Katroshi, e-mail: junida.katroshi@aab-al.org Mob.+355 69 401 4505

Për UET:

Z: Elvin Meka, e-mail: elvin.meka@uet.edu.al; Mob.+355 68 20 71 963

Znj/ Adela Danaj; e-mail: adela.danaj@uet.edu.al; Mob.+355 69 81 33 227

Neni 6

Ndryshime

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjellë me shkrim të dy palëve të përfshirë në të.



Sipas rastit, për bashkëpunime specifike palët do të nënshkruajnë një akt të dytë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 7

Përfundimi i Memorandumit

Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim, të arsyetuar nga Pala tjetër.

Palët marrin përsipër t'u përmbahen termave dhe kushteve të projektit duke ofruar dhe shkëmbyer informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, deri para datës së përfundimit të tij.


Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, një për secilën Palë. Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë 08/07/2018 dhe hyn në fuqi menjëherë.

Universiteti Europian i Tiranës sh.p.k

Administratori
Prof. Asoc. Arbi Agalliu



Shoqata Shqiptare e Bankave

Sekretari i Përgjithshëm
Dr. Spiro Brumbulli